

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
Tetor 2025

Nr.	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	07.10.2025	A ka përfunduar procesi i inventarizimit të dëmeve nga zjarret e këtij viti? Nëse po, na vini në dispozicion të dhënat e mbledhura mbi dëmët sipas bahkive të prekura Listë me personat dhe banesat/fermat që do të përfitojnë kompensim Faturën e buxhetit të shtetit për kompensimin e dëmeve Nëse jo, listoni arsyet e vonesës A është përcaktuar një afat kohor për fillimin e kompensimit? A është caktuar një vlerë specifike kompensimi për banesa, bagëti ose dëme të tjera materiale? A janë parashikuar mbështetje të tjera (p.sh. strehim i përkohshëm, furnizim me ushqime, ndihmë financiare) për personat më të prekur? Kush është institucioni përgjegjës për shpërndarjen e kompensimeve dhe rindërtimin e banesave? A ka pasur ndonjë problematikë ose vonesë deri më tani në zbatimin e premtimit të kryeministrit? Si mund të kontaktojnë qytetarët për të marrë informacion ose për të aplikuar për kompensim? A do të publikohet një raport transparent mbi përparimin e procesit?	09.10.2025	Duke ju falenderuar për interesimin, në vijim gjeni përgjigjet mbi pyetjet tuaja. Procesi i kompensimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore në Shqipëri bazohet në Ligjin nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, konkretisht nenet 40, 41 dhe 48, si dhe në aktet nënligjore përkatëse, përfshirë VKM nr. 329, datë 16.05.2012 dhe VKM nr. 345, datë 26.05.2022. Ky kuadër përcakton mënyrën e organizimit, përgjegjësitë institucionale dhe procedurat e vlerësimit e kompensimit të dëmeve. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) koordinon procesin ndërmjet strukturave qendrore dhe vendore, ndërsa bashkitë ka		

				në rolin kryesor në evidentimin, verifikimin dhe dërgimin e të dhënave për dëmet. Fondet për kompensim sigurohen nga buxheti i shtetit, nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ose nga fondet e dedikuara vendore, në varësi të përmasës së dëmeve. Në çdo bashki të prekur, me urdhër të kryetarit të bashkisë ngrihen: • Grupi i Konstatimit të Dëmeve, që evidenton dëmet në banesa, infrastruktu­rë, biznese, bujqësi apo objekte publike; • Grupi i Vlerësimit të Dëmeve, që përfshin ekspertë të fushave përkatëse dhe përcakton vlerën teknike e financiare	
--	--	--	--	---	--

			të humbjeve. Vlerësimi financiar kryhet sipas çmimeve dhe standardeve zyrtare në fuqi — për ndërtimet nga Enti Kombëtar i Banesave, për bujqësinë nga Ministria e Bujqësisë, dhe për pajisjet shtëpiake nga Drejtoria e Tatimeve. Pas miratimit të preventivave, bashkia përgatit listat emërore të përfituesve, të cilat kalojnë për verifikim e miratim pranë strukturave qendrore. Në rastet kur dëmet tejkalojnë 8% të buxhetit vendor, bashkia i drejtohet Prefektit të Qarkut dhe AKMC-së, e cila mund të propozojë financimin nga Programi i Emergjencave Civile ose përmes një Vendimi të posaçëm të Këshillit të Ministrave. 1. A ka përfunduar procesi i inventarizimit të dëmeve nga zjarret	
--	--	--	--	--

				e këtij viti? Procesi është në fazë përmbyllës e dhe po zhvillohet në bashkëpunim me bashkitë e prekura. Të dhënat përfundimtare do të publikohen pas verifikimit dhe miratimit nga strukturat përgjegjëse, për të siguruar saktësi dhe transparencë. 2. Listë me personat dhe banesat/fermat që do të përfitojnë kompensim Listat po finalizohen nga bashkitë dhe do të miratohen nga institucionet përgjegjëse pas përfundimit të	
--	--	--	--	---	--

				verifikimeve. 3. Fatura e buxhetit të shtetit për kompensimin e dëmeve Vlera totale do të përcaktohet pas miratimit të raporteve përfundimtare, në koordinim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. 4. Nëse jo, listoni arsyet e vonesës Vonesat lidhen me nevojën për verifikim të detajuar në terren dhe krahasimin e të dhënave mes bashkive dhe institucioneve qendrore, për të garantuar trajtim të drejtë dhe ligjor të çdo rasti.	
--	--	--	--	---	--

				5. A është përcaktuar një afat kohor për fillimin e kompensimit? Afatet do të publikohen pas miratimit të listave përfundimtare dhe alokimit të fondeve nga buxheti i shtetit. 6. A është caktuar një vlerë specifike kompensimi për banesa, bagëti ose dëme të tjera materiale? Po, kompensimi do të përcaktohet sipas shkallës së dëmit dhe kriterëve ligjorë të miratuara për çdo sektor. 7. A janë parashikuar mbështetje të tjera për personat më të prekur?	
--	--	--	--	---	--

				Po, në bashkëpunim me autoritetet vendore janë ndërmarrë masa të përkohshme si strehim emergjent, furnizim me ushqime dhe ndihmë financiare për rastet më të rënda. 8. Kush është institucioni përgjegjës për shpërndarjen e kompensimeve dhe rindërtimin e banesave? AKMC mbështet bashkitë dhe institucionet e tjera shtetërore për administrimin dhe koordinimin e procesit. 9. A ka pasur ndonjë problematikë ose vonesë deri më tani në	
--	--	--	--	--	--

				zbatimin e premtimit të kryeministrit? Procesi po zhvillohet sipas procedurave ligjore dhe koordinimit ndërinstitucional; çdo vonesë lidhet me verifikimin dhe dokumentimin e plotë të dëmeve. 10. Si mund të kontaktojnë qytetarët për të marrë informacion ose për të aplikuar për kompensim? Qytetarët mund të drejtohen në bashkitë përkatëse për çdo informacion apo udhëzim mbi procedurat e aplikimit. 11. A do të publikohet një raport transparent mbi përparimin	
--	--	--	--	--	--

				e procesit? Po, pas përfundimit të vlerësimeve do të publikohet një raport përmbledhës me të dhënat e verifikuara dhe masat e marra, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nëse keni nevojë për sqarime të mëtejshme, jam në dispozicion. Me respekt.	
--	--	--	--	--	--